



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:913586

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05726780

Ac.nr.6063/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Salluka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H..... R..... nga fshati Tërrnje Komuna e Suharekës të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Z..... I..... nga Prishtina rr. “Bill Klinton” blloku 1/A, hyrja 69 kati I nr.1, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, me padi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.50/2021 të datës 21.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.50/2021 i datës 21.06.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.50/21 të datës 21.06.2021, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit H.....R..... nga fshati Tërrnje Komuna e Suharekës. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial për aksidentin e datës 25.08.2016 në Suharekë në rrugën “Brigada 123” në afërsi të restaurant “Rozafa”, shumën përgjithshme prej 2.336,00 euro me kamatë ligjore 8 % nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit gjer në pagesën definitive dhe atë Në emër të dëmit jomaterial për dhimbjeve fizike shumën prej 1.150,00 euro, në emër të frikës shumën prej 1.050,00 euro. Në emër të dëmit material: për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumën prej 70 euro, për ushqimin e përforcuar shumën prej 50 eur, për shpenzimet e shërimit sipas faturave të bashkangjitura shumën prej 16 euro. Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit Hekuran Rexhaj, mbi shumën e aprovuara si në dispozitiv, i ka refuzuar si të pabazuara. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka obliguar të paditurë paditurën që paditësit

t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 874 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të shkelejeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësi nuk ka parashtrur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195, paragrafi, 1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi H..... R..... nga fshati Tërrnije, Komuna e Suharekës, përmes përfaqësusit të autorizuar Z..... I....., avokat nga Prishtina, ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material me rastin e aksidentit të komunikacionit, ndaj të paditurës Kompanisë së Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, ndërsa me datë 02.11.2018 ka precizuar kërkespadinë me të cilën ka kërkuar që paditësi të kompensohet për dëmin jomaterial gjegjësisht për dhimbjet fizike në shumë prej 2000 euro, për frikën e përjetuar në shumë prej 1500 euro ndërsa për dëmin material dhe atë për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumë prej 70 euro, për ushqim të përforcuar shumë prej 50 euro dhe për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumë prej 16 euro dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija e precizuar të aprovohet si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, për taksën gjyqësore për padi shumë prej 30 euro, për shpenzimet e ekspertizës mjekësore shumë prej 200 euro për tri seanca të mbajtuara shumë nga 135 euro (405 euro) apo gjithsejtë shumë prej 739 euro dhe njëkohësisht për përfaqësimin në këtë seancë ka kërkuar shumë prej 135 euro.

I autorizuari i të paditurës S..... D....., në seancë ka deklaruar se qëndron pranë deklarimeve si në seancën paraprake që kishte referencën C.nr.323/2016 duke shtuar se në këtë fazë të procedurës jemi të gatshëm që kontestin ta mbyllim në lartësi prej 1500 euro si dhe t'i paguajm shpenzimet procedurale, në qoftëse kjo ofertë nuk pranohet konsiderojm që çështja duhet të shkojë në fjalë përfundimtare, ndërsa me rastin e hartimit të aktgjykimit nëse oferta nuk pranohet, gjykatës i propozoj që t'i refuzoj shumat mbi ofertën e dhënë në seancën e sotme, sa i përket pjesës që ka të bëjë me kamatën propozoj që e njëjta të merret në konsideratë nga data e nxjerrjes së aktgjykimit dhe jo nga data e ushtrimit të padisë, e gjitha kjo referuar edhe praktikës gjyqësore, pjesa që ka të bëjë me shpenzimet propozoj që të merret në konsideratë neni 452 pika 2 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.50/2021 të datës 21.06.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se nga raporti i aksidentit me nr.2016-GR-0679 të datës 25.08.2016 është konstatuar fakti se aksidenti ka ndodhur me datë 25.08.2016 si pasojë e pakujdesisë së të siguruarit tek e paditura duke i shkaktuar lëndime këmbësorit këtu paditësit H..... R..... Nga raporti mjekësor i shërbimit urgjent të Q.K.M.F në Suharekë me nr. të protokollit 24221 të datës 25.08.2016 si dhe nga shkresat e lëndës është konstatuar se paditësi menjëherë pas aksidentit është drejtuar për në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Suharekë me ç'rast të njëjtit i është dhënë ndihma e parë, më pastaj ka vazhduar edhe me egzaminimet përkatëse. Nga raporti i ordinacës specialistike “Medica” në Suharekë të datës 25.08.2016 si dhe në kuponat fiskal të bashkangjitura shkresave të lëndës u konstatuan shpenzimet materiale të krijuara gjatë shërimit të paditësit. Nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit S..... F..... të dhënë në procedurë penale PP/II nr. 2369-6/20 16 të datës 19 dhe 20.11.2016 është konstatuar se aksidenti ka ndodhur për shkak se ngasësi i automjetit nuk ka pasur koncentrim të shtuar dhe kujdes të veçantë duke mos i dhënë përparësi kalimi këmbësorit, gjegjësisht nuk e ka përshtatur shpejtësin e veturës me kushtet ekzistuese të rrugës që ka rezultuar me këtë aksident. Eksperti mjekësor Dr.M..... H..... – ortoped traumatolog në seancë gjyqësore, ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të cilat kanë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë një ditë, të intensitetit të mesëm 16 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në formë të dhimbjes së kokës dhe qafës të cilat janë të shprehura në mëngjes dhe gjatë mësimimit të gjatë. Zvogëlimi i aktivitetit jetësor dhe shëmtimi trupor nuk ekziston tek i lënduari. Ndhma e personit të huaj ka qenë e nevojshme për 18 ditë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 16 ditë, rehabilitimi fizioterapeutik nevojitet prej 7 ditësh. Eksperti mjekësor Dr.J... Z..... ekspert i psikiatrisë, në seancë gjyqësore për paditësin H..... R..... ka konstatuar se i njëjti si pasojë e aksidentit ka qenë i ekspozuar nga një gjendje traumatike me ç'rast ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatë disa sekonda e cila ka kaluar në frikë të intensitetit të lart që ka zgjatur 2-3 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 10 ditë që është manifestuar me rikujtime të përsëritura dhe të imponuara të ngjarjes duke përfshirë pamjet, mendimet apo perceptimet dhe frikë të intensitetit të ulët ka zgjatur për një periudhë prej 2 muaj deri në disa vite pas aksidentit e shoqëruar me brengën për gjendjen dhe stresin të cilin e ka përjetuar në momentin e aksidentit si dhe përpjekjet për ti evituar mendimet, ndjenjën apo bisedën në lidhje me traumën. Gjykata pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ekspertizave të ekspertëve të lamive përkatëse të hartuar me shkrim dhe nga ekzaminimi i drejtpërdrejtë në seancë gjyqësore të të dëmtuarit këtu paditësit, vendosi që pjesërisht të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ia falur besimin e plotë ekspertizës së Dr.M..... H..... – ortoped traumatolog dhe Dr.J..... Z..... – ekspert i psikiatrisë të cilët ndër të tjerash kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore të cilat janë manifestuar me dhimbje fizike, frikë, me nevojën për ndihmën e personit të tretë dhe të ushqimit të përforcuar të përshkruar si më lart, njëherit gjykata ia fali besimin edhe ekspertizës me shkrim të ekspertit Inxh. Dipl. i Komunikacionit S.....F..... e cila

gjindet në shkresat e lëndës nga e cila u konstatua saktë se deri te aksidenti ka ardh si pasojë e pakujdesisë dhe lëshimeve të drejtuesit të automjetit i cili ka qenë i siguruar tek e paditura. Gjykata e bazoi vendimin e saj në nenin 136 pika 1, nenin 179 pika 1, neni 183 paragrafi 2 të LMD-së dhe nenin 10 dhe 15 par.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia të Ligjit nr.04/L-018. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës u referua në nenin 452 të LPK-së. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara, duke vlerësuar se shumat e kërkuara me kërkesëpadi gjegjësisht me precizimin e kërkesëpadisë përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurës.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave nga e drejta materiale, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk gjeti as shkelje që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, e as shkeljeve të tjera nga neni 181 paragrafi 1 dhe 182 paragrafi 2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për aprovimin e pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditëses.

Një ashtu, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, kur me rastin e vendosjes, është zbatuar neni 136, paragrafi 1 i LMD-së, që përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*, dhe gjithashtu edhe neni 179 të LMD-së që përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”*. Në këtë kontest refuzohet si i pa bazë pretendimi ankimor i të

paditurës e cila në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar nenin 159 të LMD-së e cila dispozitë ligjore është më relevante në rastin konkret, kjo për arsye se në rastin konkret i siguruari i të paditurës ka përgjegjësi ekskluzive në shkaktimin e aksidentit, e cila është vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit, pra drejtë është zbatuar ndispozita e nenit 159 në lidhje me nenin 136 të LMD-ës. Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e referimit në dispozitën ligjore të nenit 136 të LMD-së e cila dispozitë rrjedh përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, prandaj, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se pretendimet ankimore të palës së paditur në raport me mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, rezultojnë të pa bazuara dhe pa argumentuara dhe si të tilla refuzohen.

Ndërkaq, edhe pretendimet ankimore të të paditurës shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për kompensimin e dëmit jo material dhe material, gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat në bazë të vlerësimeve profesionale të ekspertëve mjekësor në ekspertiza e tyre të cilët kanë konstatuar lëndimet e pësuar nga paditësi janë të natyrës së lehtë trupore. Andaj, për këtë gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në dispozitat e nenit 183 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e sidomos duke pasur parasysh shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, për çka edhe Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumat e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par. 2 të LMD-së, i cili decidivisht thotë se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Si rrjedhojë, nga arsyet e cekura si më lartë edhe pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat pa u mbështetur në asnjë dispozitë ligjore janë plotësisht të pabazuara.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, datës 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm,

shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e ushtrimit të padisë për dëmin material ndërsa për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Lartësia është në përputhje me tarifën për përfaqësim dhe po ashtu në përputhje me tarifën për taksa gjyqësore dhe ekspertiza. Pala e paditur është obliguar për pagesën e shpenzimeve procedurale bazuar në dispozitën ligjore të nenit 452 paragrafi 1 të LPK së ku parashihet se *“pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në rastin konkret e paditura e ka humbur procesin gjyqësor.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6063/2021 me datë 21.05.2024

**Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi**